

**3**  
**6**  
**9**

**GARA E 3, 6 DHE 9 ME PENGESA**  
Vëzhgim i zbatimit të tre muajve  
të parë të Planit 3-6-9

*Nëntor 2017*

*Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Institutit për demokraci “Societas Civilis” - Shkup*

# IMPRESUM

**Titulli:** Gara e 3, 6 dhe 9 me pengesa. Vëzhgim i zbatimit të tre muajve të parë të Planit 3-6-9, nëntor 2017

**Botues:** Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për demokraci „Societas Civilis“ - Shkup

**Autor:** Zoran Neçev  
në bashkëpunim me Ivan Nikollovski

**Lektura:** Vineta Ognenoska

**Dizajn dhe përgaditje:** Vladimir Barlakoski

*Publikimi mund të shkarkohet falas në linkun në vijim:*

*<http://www.kas.de/mazedonien/>*

*<http://www.idscs.org.mk>*

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

323.1(497.7)“2017“(047)

NEÇEV, Zoran

Gara e 3, 6 dhe 9 me pengesa : vëzhgim i zbatimit të tre muajve të parë të Planit 3-6-9, nëntor 2017 / autor Zoran Neçev. - Shkup : Instituti për demokraci „Societas civilis“ - (IDSCS), 2017. - 15 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 15

ISBN 978-608-4775-26-3

а) Македонија - Демократски процеси - Извештаи

COBISS.MK-ID 105160458

# GARA E 3, 6 DHE 9 ME PENGESA VËZHGIM I ZBATIMIT TË TRE MUAJVE TË PARË TË PLANIT 3-6-9

*Autor: Zoran Neçev*

*Nothing is possible without men;  
nothing is lasting without institutions.*

*- Jean Monnet -*

## Qëllim ambicioz

Qeveria e re e Republikës së Maqedonisë, e udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë dhe partnerët e koalicionit Bashkimi Demokratik për Integrim dhe Nga Aleanca e shqiptarëve, i parashtrori vetes si qëllim që t'i hapë perspektivat për hyrje të shtetit në UE.<sup>1</sup> Kjo parimisht do të thotë kthyerje të rekomandimit të pastër për fillimin e negociatave, por edhe intencë që të bindet Këshilli dhe vende-anëtare të caktuara që janë skeptike se Maqedonia është përgatitur për këtë. Përmbushja e rekomandimeve që qëndrojnë në raportin e Pribes nga viti 2015 dhe të Prioriteteve urgjente reformuese është kyç për marrjen e rekomandimit të pakushtëzuar për fillimin e negociatave për fillim të negociatave për anëtarësi nga Komisioni Evropian.

---

1 Zoran Zaev, "Statement by H.E. Zoran Zaev, President of the Government of the Republic of Macedonia, at the 72th Session of the United Nations General Assembly Plenary Meeting," 2017, 4, [https://gadebate.un.org/sites/default/files/gastatements/72/mk\\_en.pdf](https://gadebate.un.org/sites/default/files/gastatements/72/mk_en.pdf).

Raporti i fundit vjetor i Komisionit Evropian i vitit 2016 e karakterizoi Maqedoninë si “shtet të kapur” me institucione të robëruara,<sup>2</sup> duke theksuar në të njëjtën kohë se vendi ballafaqohet me krizën më të rëndë politike që nga viti 2001. Ky është rasti i parë në procesin e aderimit, kur Maqedonisë i jepet një diagnozë e tillë negative. E ballafaquar me pasiguri politike në të cilën funksiononte shteti në dy vitet e kaluara, vendosja e një qëllimi të tillë nga Qeveria aktuale duket si një gjë tejet ambicioze.

Gjatë shtatorit të vitit 2017, grupi i ekspertëve të shquar të drejtësisë i udhëhequr nga Pribe e shpalli edhe raportin e vetë të dytë me rekomandime. Në këtë raport, krahas asaj që u bën vështrim rekomandimeve të vitit 2015, jep edhe rekomandime të reja për reformat të cilat Maqedonia duhet ti vijojë dhe përmbush për tu penguar mundësia që një “shtet i kapur” të zëvendësohet me një tjetër të tillë.<sup>3</sup> Duke e marrë parasysh këtë që është shënuar më lartë, Qeveria duhet seriozisht ti përkushtohet zbatimit të reformave duke i vijuar me këtë rast rekomandimet e Qeverisë duhet seriozisht ti kushtohet zbatimit të reformave nga raporti i Pribes të vitit 2015 dhe 2017, si dhe Prioritetet urgjente reformuese.

---

2 Komisioni Evropian, „Raport për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2015“, Komisioni Evropian, 2015, 8, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf); Komisioni Evropian, “Raport për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2016,” Komisioni Evropian, 2016, 4, 8, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf).

3 Grup ekspertësh, “Vlerësim dhe Rekomandime I Grupit të Ekspertëve Për Çështjet Sistemore Të Sundimit të Ligjit 2017,” Komisioni Evropian, 2017, 3, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf).

Operacionalizimi i përpjekjes së tillë të Qeverisë filloi me shpalljen e planit të reformave të ndërlidhura me procesin e aderimit, të titulluar Plani 3-6-9. Gjeneza e titullit të tillë buron nga korniza kohore të cilën i njëjti e vendos për përfundimin e aktiviteteve të caktuara të ndërlidhura me UE reformat dhe përfundimi i të cilave përkon me kohën e shpalljes së raportit të rregullt të Komisionit Evropian për Maqedoninë. Plani është i publikuar më 04.07.2017, pothuajse një muaj pas themelimit të Qeverisë së re.

## Kthyerja drejt demokracisë

---

Në drejtim të marrjes së rekomandimit të pastër për fillimin e negociatave me UE dhe krijimin e klimës pozitive për përparim në negociatat me Greqinë, nevojitet që Maqedonia të tregojë pjekuri politike dhe aftësi që ti zbatojë hapat reformuese të cilat, së paku në mënyrë deklarative, i përkrahin të gjithë faktorët politik dhe institucional. Prandaj, Qeveria në të cilën para së gjithash qëndron edhe përgjegjësia më e madhe, duhet të ndër marrë hapa konkrete drejt arritjes së konsensusit dhe përkrahjes politike nga të gjitha partitë politike, posaçërisht nga ato parlamentare. Bashkimi mbipartiak rreth përpjekjeve për realizimin e përcaktimit strategjik për anëtarësi në UE përmes miratimit të Deklaratës në Kuvend<sup>4</sup> është hap në drejtim të vërtetë, por në të njëjtën kohë, ajo nuk paraqet përkrahje thelbësore për aktivitetet dhe reformat të cilat burojnë nga kjo rrugë. Qeveria rregullisht duhet tu raportojë dhe të konsultohet me të gjitha partitë politike për Planin 3-6-9 në kuadër të Komisionit

---

4 Komisioni për çështje evropiane, “Deklaratë për përshpejtimin e proceseve reformuese dhe integruese për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian dhe në NATO,” Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, July 14, 2017, [https://www.sobranie.mk/2016-2020-srm-ns\\_article-komisijata-za-evropski-prashanja-go-razgleda-planot-3-6-9.nspX](https://www.sobranie.mk/2016-2020-srm-ns_article-komisijata-za-evropski-prashanja-go-razgleda-planot-3-6-9.nspX).

kuvendor për çështje evropiane ashtu edhe në seancat plenare të Kuvendit. Kjo është me rëndësi si për informimin e palëve të prekura, ashtu edhe për shkak të harmonizimit të reformave në nivelin më të lartë të mundur.

Megjithatë, kthimi në demokraci duhet të bëhet me respektimin e plotë të parimit të ndarjes së pushtetit. Kjo është me rëndësi të posaçme duke pasur parasysh se Maqedonia bën përpjekje që të dalë nga gjendja e të a.q. “shtet të kapur”. Prandaj, karakteri i këtij plani reformues duhet ta pasqyrojë këtë realitet. Duke pasur parasysh faktin se Qeveria është ajo e cila raporton në Bruksel për atë që është realizuar, ajo e ka edhe përgjegjësinë më të madhe gjatë përpilimit dhe zbatimit të planit. Formulimi i aktiviteteve dhe të ndërhyrjeve reformuese në fushat të cilat janë në kompetencë të shtyllave të tjera të pushtetit, para së gjithash të pushtetit ligjdhënës dhe gjyqësor, patjetër duhet të bëhet me kujdes të posaçëm. Fitohet përshtypja se ende nuk është arritur niveli i duhur. Në fushën e cila i mbulon aktivitetet e parapara për punën e Kuvendit, i vetmi aktivitet i Qeverisë mund të jetë që tu urdhërojë funksionarëve dhe udhëheqësve të vet në ministritë dhe organet që i ka në përbërje, si dhe të trupave të tjerë të themeluara nga Qeveria, që në mënyrë të obliguar të asistojnë në ftesat për pjesëmarrje në seancat kuvendore të ndërlidhura me Planin 3-6-9, por edhe më gjerë. Përveç kësaj, ka nevojë të mendohet nëse mungesa e bartësve të përmendur më lartë të funksioneve mund të jetë bazë për sanksionimin e tyre. Vetëm ashtu Qeveria do të tregojë mirëkuptim të vërtetë për rolin e vet në sistemin demokratik të sundimit dhe do të lë hapësirë që vetë Kuvendi të nxisë reforma të cilat do të kontribuojnë për funksionimin e tij më efikas dhe më thelbësor. Si rrjedhojë, të gjitha masat e propozuara në sferën “Kuvendi” duhet të burojnë nga dhe të promovohen përmes propozimeve të cilat vijnë nga vetë partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin në bashkëpunim me përfaqësues nga Qeveria. Gjithashtu, sfera që i është kushtuar kohabitacionit me Presidentin parashikon

aktivitete që gjithashtu dalin jashtë nga ingerencat e pushtetit ekzekutiv si për shembull zgjedhja e anëtarit në Këshillin e prokurorëve publik dhe në Gjykatën Kushtetuese.

## Vlerësim i gjendjes reale

---

Në bazë të metodologjisë për vëzhgim të implementimit të Planit 3-6-9 u vërtetua se nga gjithësej 73 aktivitete, 41% nga aktivitetet janë përmbytur, 16% janë aktivitetet janë përmbytur pjesërisht, 14% nuk janë përmbytur, ndërsa 29% nga aktivitetet janë të pamatshme.

Përkundër ambiciozitetit të Qeverisë për kthyerje në rrugën drejtë UE, aktivitetet e parapara në Planin janë larg nga niveli i dëshiruar të aktiviteteve reformuese të cilat Sekretariati për çështje evropiane (SÇP), dhe me këtë edhe Qeveria, ka kapacitet ti përgatit dhe përcjellë. Në atë as janë përcaktuar qëllimet reformuese për çdo fushë prioritare veç e veç, e as është bashkëngjitur sqarim për mënyrën në të cilën disa fusha janë të prioritetizuara në raport me disa të tjera. Në mënyrë shtesë, në preambulën e Planit vihen në pah dokumente të shumta nga të cilat nxirren prioritetet e të njëjtit. Megjithatë, në Planin mungon sqarimi ose ndërlydhje e aktiviteteve të parashtruara me aktivitetet dhe propozimet për ndërhyrje reformuese në dokumentet në të cilat thirret i njëjti. Gjithashtu, vërehet edhe mungesa e një numri të madh të aktiviteteve të cilat do të duhej ti adresojnë rekomandimet dhe prioritetet kyç që i përmban Raporti i Pribes dhe Prioritetet urgjente reformuese. I tillë është shembulli me rekomandimet për reforma në trupat mbikëqyrëse dhe rregullatore – fusha për të cilat në mënyrë ekstensive flitet



në rekomandimet e Pribes.<sup>5</sup> Pothuajse edhe nuk ka aktivitete të parapara në këto fusha në pjesën 3. Përveç kësaj, disa nga aktivitetet e parapara në pjesën 3 në mënyrë jo-përkatëse i adresojnë rekomandimet dhe prioritetet e lartpërmendura. Për shembull, në fushën e medieve, pjesa 3 parashikon pasqyrë të të gjitha rasteve të deritanishme të sulmeve dhe presioneve fizike dhe verbale mbi gazetarët<sup>6</sup>, por nuk thotë asgjë për atë se si do të veprohet në rastet e padive për shpifje ndaj gazetarëve nga ana e politikanëve, të cilat shpesh herë përdoren si presion mbi mediet.<sup>7</sup>

Me rëndësi tejet të madhe është të përmendet nevoja e harmonizimit të aktiviteteve reformuese në Planin 3-6-9 me Programin nacional për adoptimin e ligjeve të UE (NPAA). Ky dokument paraqet dokument kyç, strategjik, i cili i përfshin prioritetet, dinamikën e harmonizimit të legjislativit nacional me atë evropian, si dhe përshtatje e institucioneve nacionale ndaj strukturave administrative evropiane. Me rëndësi është arritja e komplementaritetit për shkak se Plani 3-6-9 është instrument i jashtëzakonshëm me afat të caktuar të kohëzgjatjes. Në sajë të NPAA të fundit (2016 – 2019)<sup>8</sup> dhe të aneksit (2017 – 2020)<sup>9</sup>, si shembull i ndërlidhjes mund të vihen në pah Ligji për gjykatat,

---

5 Senior Experts' Group, "Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on Systemic Rule of Law Issues Relating to the Communications Interception Revealed in Spring 2015," European Commission, 2015, 13–18

6 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Plani 3-6-9,” Sekretariati për çështje evropiane, July 4, 2017, 4, <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan%203-6-9%20MK.pdf>.

7 Senior Experts' Group, "Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on Systemic Rule of Law Issues Relating to the Communications Interception Revealed in Spring 2015," 20.

8 Sekretariati për çështje evropiane, "Pasqyrë e akteve nacionale juridike që janë lëndë e harmonizimit me legjislativin e UE 2016," Mars 17, 2016.

9 Sekretariati për çështje evropiane, „Pasqyrë e akteve nacionale që janë lëndë e harmonizimit me legjislativin e UE 2017-2020,” Mars 17, 2016.

Ligji për këshillin gjyqësor, Ombucmani, Ligji për përcjellje të komunikimeve si dhe Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme – ligje të cilat i përfshijnë çështjet që janë objekt i interesimit të Planit 3-6-9. Megjithatë, shihet qartë se asnjë nga ligjet e theksuara më lartë nuk është miratuar në afatin e përcaktuar kohor në pajtim me NPAA.

Aktivitete të caktuara të parapara në planin nuk paraqesin ndërhyrje reformuese, në mënyrën në të cilat janë definuar, dhe në të njëjtën kohë nuk lënë hapësirë për përcaktim të treguesve për implementimin e tyre. I tillë është shembulli në pjesën e migracioneve ku përcaktohen aktiviteti “inicimi i takimeve teknike me KE dhe Shengen rregullat” ose ndërkaq aktiviteti “mbajtje e konsultimeve të rregullta me KE në raport me tekstin e Projekt-Strategjinë” në pjesën e reformave gjyqësore. Në aktivitetet e tilla dhe të ngjashme të cilat shpijnë deri në ndryshime të caktuara ligjore ose akte të tjera, rekomandohet riformulimi i tyre gjë e cila do të kishin shpjerë deri te konkretizimi i tyre me aktivitete dhe faza procesuim saktësisht të definuar. Shembull i mirë për atë është metodologjia e cila përdoret gjatë hartimit të NPAA, sipas së cilës procesi i harmonizimit i legjislativit nacional me atë të UE, përcaktohet në sajë të disa treguesve dhe atë: 1) Ligje të miratuara dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare, 2) ligje të cilat kanë hyrë në procedurë kuvendore, 3) ligje të cilat janë në procedurë qeveritare, 4) ligje të cilat janë në fazë të konsultimit mes resorëve, 5) ligje teksti i të cilëve është në fazë të përgatitjes. Sa ju përket aktiviteteve të cilat përfshijnë dialog ose konsultime, ato duhet të përfshijnë dinamikë të planifikuar të mbajtjes së takimeve si dhe modalitet të konsultimeve dhe përfshirje të palëve të prekura.

Thelbësore është nevoja për definimi e qëllimit përfundimtar të aktiviteteve dhe reformave të propozuara. Pa marrë parasysh se është bërë përpjekje për atë, plani në mënyrë të pamjaftueshme e pasqyron drejtimin dhe qëllimin të cilin Qeveria dëshiron ta

arrijë ose ta plotësojë. Si rrjedhojë e kësaj, mos publikimi i pjesëve 6 dhe 9, gjatë publikimit të planit, në mënyrë të konsiderueshme e vështirëson vijimin e tij dhe lë përshtypje të mos ekzistimit të kursit të përcaktuar qartë të zbatimit të reformave.

Kjo lë përshtypje se disa pjesë të Planit nuk janë komplementare njëra me tjerat, ndërsa aktivitetet reformuese nuk kanë vazhdimësi. Me fjalë të tjera, parashtrohet pyetja nëse këto aktivitete të cilat nuk do të përmbushen në kuadër të afatit të paraparë prej tre muajve dhe ato aktivitete për të cilat parashihet vetëm faza fillestare e realizimit do të përfshihen në pjesën 6 përkatësisht 9 të planit. Në këtë grup hyjnë edhe aktivitetet për formimin e grupeve të punës si fazë fillestare drejtë përgatitjes së zgjidhjes së caktuar ligjore, ndërsa të tilla ka pothuajse në të gjitha fushat reformuese të përfshira me planin.

Ndërkaq, aktivitete të tjera paraqesin manifestim të vullnetit politik. Për shembull, në pjesën e reformave gjyqësore, është paraparë aktivitet që parashikon “inkurajim” të Këshillit gjyqësor nga ana e Qeverisë në drejtim të nxitjes së gjykatësve që të paraqesin presione gjatë punës së tyre. I ngjashëm është edhe aktiviteti i cili parashikon dhënie të përkrahjes për punën e Prokurorisë Publike Speciale. Gjithashtu janë të pranishme edhe aktivitete, si për shembull, fuqizimi i kapaciteteve të Avokatit të popullit, të cilat aspak nuk hyjnë në fushat me të cilat janë të përfshira – ne rastin konkret “gjyqësinë”.

Në fund, Qeveria duhet ti marrë parasysh edhe kapacitetet vetanake administrative gjatë konceptimit të aktiviteteve dhe të reformave. Përveç kësaj, duke e marrë parasysh gjendjen shoqëro-politike, ajo që tanimë është paraparë në Planin dhe ajo që do të planifikohet në të ardhmen, duhet të jetë reale dhe të mund të realizohet në afatin e përcaktuar. Duhet të shmangët situata në të cilën do të vendosen qëllime tejet të larta në një kornizë jo reale kohore. Gjithsesi, kjo nuk guxon të bëhet me

çmim të mos-ndërmarrjes së aktiviteteve përkatësisht të mos-fillimit të reformave të rëndësishme për të cilat nevojitet një periudhë më e gjatë kohore.

Përfshirja e profesionistëve dhe të ekspertëve nga jashtë në shërbimin shtetëror është më se e nevojshme për arritje të qëllimit dhe për fillimin e negociatave. Shembuj të tillë tanimë ka në fqinjësinë tonë, në vende të cilat janë shumë më përpara në proceset eurointegruese. Thirrjet e Kryetarit të Qeverisë – Zaev dhe të Nënkretarit për çështje evropiane – Osmani për transparencë dhe përfshirje të palëve të prekura në proceset eurointegruese janë hapa në atë drejtim, por ende pritet në operacionalizimin e tyre të mëtejshme. Nëse mbetet në nivelin për pjesën 3 nga plani, atëherë ato thirrje do të mbeten vetëm në nivel deklarativ. Pa marrë parasysh se është për tu përshëndetur prania e përfaqësuesve të Qeverisë në takimet me organizatat civile në të cilat, mes të tjerave u debatua edhe për Planin 3-6-9, modeli i njëjtë për përfshirje dhe bashkëpunim të organizatave civile me Qeverinë nuk kontribuon për përfshirje të vërtetë dhe thelbësore të organizatave civile në përcjelljen, avancimin dhe promovimin e planit reformues. Si rrjedhojë, imponohet nevoja për përfshirje urgjente strukturore të sektorit më të gjerë civil në procesin. Në pajtim me praktikën e vendosur dhe funksionimin e grupit të punës ndër-sektorial për përcjellje të implementimit të Planit 3-6-9 në Qeverinë, një nga propozimet të cilat do të duhej të shqyrtohet do të kishte qenë përfshirje përmes informimit të rregullt (të paktën një herë në muaj) të organizatave civile që do ta bëjë ky ad-hok grup i ekspertëve. Kjo do të kontribuojë drejtë bashkëpunimit më të mirë, përmirësim të kushteve për përcjellje dhe komentim në kohë për ndërhyrjet reformuese, e jo pasi të njëjtat do të fillojnë me implementimin. E tërë kjo është në drejtim të arritjes së rezultateve më të mira në një mënyrë më efektive dhe lëvizje të shtetit përpara në proceset eurointegruese.

## Përcaktimi i drejtë i prioriteteve

---

Duhet të tejkalohet mungesa e vërejtur e prioretizimit përkatës të reformave në Planin, si në nivel të fushave prioritare, ashtu edhe në nivel të aktiviteteve në kuadër të fushave. Prioretizimi jo-përkatës i fushave dhe aktiviteteve reformuese është thelbësor, por edhe i dukshëm duke e pasur parasysh radhitjen sipas së cilës janë të prezantuara fushat dhe aktivitetet. Për shembull, reformat në gjyqësinë janë të vëna në pah si primare edhe në rekomandimet e Pribes dhe në Prioritetet urgjente reformuese, ndërsa në Planin 3-6-9 ato janë të vëna në pah si fushë reformuese e teta me radhë. Më konkretisht, në nivel të aktiviteteve, në fushën e reformave gjyqësore, më së pari janë paraparë ndryshime të ligjeve nga fusha e gjyqësisë, projekt – strategjisë për reformë të sistemit gjyqësor, që në fund, të parashihet formimi i Këshillit për zbatim të reformave në gjyqësinë i cili është kompetent për hartimin e projekt-strategjisë. E tërë kjo krijon konfuzion te lexuesi dhe lë përshtypje se aktivitetet janë të shënuara duke mos e pasur parasysh fotografinë më të madhe, fazat e procesit reformues dhe qëllimi përfundimtar i cili duhet të shpijë strategjia e re. Gjithashtu, përfitohet një pasqyrë e paqartë për rëndësinë e njërave reforma në raport me reformat e tjera.

Në të njëjtën kohë, me rëndësi është të përcaktohet edhe pesha e ndryshme e reformave në vetë Planin. Për shembull, fusha “migrimi” përfshin reforma përmbushja e të cilave, ashtu siç është paraparë, nuk do të duhej të has në vështirësi më të mëdha në zbatimin. Për dallim nga kjo pjesë, pjesa e reformave gjyqësore ka peshë të madhe, dhe prek drejtpërdrejtë në esencën e “çlirimit” të “shtetit të kapur” dhe në institucionet e robëruara. Krahas kësaj, zbatimi i këtyre reformave duhet të qëndrojë mbi një konsensusi të gjerë politik dhe institucional sepse ka një numër të madh të ligjeve deputetë se sa shumica ekzistuese

qeverisë në Kuvendin. Kjo situatë aspak nuk është e reflektuar në kuadër të Planit. Me këtë rast, zgjidhja e gjetur për përfshirjen e palëve të prekura kryesore në këtë pjesë, para së gjithash të Këshillit gjyqësor, përçon fotografi negative për qëllimet e Qeverisë në implementimin e reformave, përmes vënies në pah të anëtarit të grupit punuese nga ky institucion.

## Metodologjia sipas së cilës do të vijohet implementimi i Planit 3-6-9

---

Përmbushja e aktiviteteve vëzhgohet duke përcaktuar tregues dhe në disa raste nën-tregues. Matja e statusit së shkallës së përmbushjes së aktiviteteve do të zhvillohet sipas logjikës vijuese: 1. E zbatuar; 2. Pjesërisht e zbatuar (në vazhdë e sipër); 3. E pa zbatuar; 4. E pamatshme/nuk mund të përcaktohet. Mënyra e këtyre të përcjelljes rrjedh nga vetë natyra dhe mënyra në të cilën janë përcaktuar aktivitetet në Planin.

***E zbatuar:*** Si të përmbushura konsiderohen ato aktivitete treguesit e të cilave vënë në pah se aktiviteti i paraparë është i përmbushur në kuadër të afatit të paraparë kohor prej 3 muaj përkatësisht përfundimisht me zgjedhjet lokale.

***Pjesërisht e zbatuar (në vazhdë e sipër):*** Për pjesërisht të përmbushur konsiderohen ato aktivitete treguesit e të cilëve dhe nën-treguesit janë pjesërisht të plotësuar; është i përmbushur vetëm një tregues (në rast të më tepër treguesve); ose janë përmbushur treguesit, por jo edhe nën-treguesit.

***E pa zbatuar:*** Si të pa përmbushur do të llogariten ato aktivitete treguesit dhe nën-treguesit e të cilëve vënë në pah se aktiviteti i parashikuar nuk është përmbushur në afatin e

paraparë ligjor.

***Nuk mund të përcaktohet:*** Për aktivitetet statusi i të cilave i plotësimit nuk mund të përcaktohet konsiderohen ato aktivitete për të cilat nuk do të ekzistojë burim kredibil se janë të zbatuara, të pa zbatuara, përkatësisht pjesërisht të pa zbatuara; aktivitete të cilat duhet të ri-formulohen për tu përcaktuar treguesit; aktivitete të cilat sipas natyrës së vet janë kompetencë resore e institucionit kompetent si dhe aktivitete të cilat sipas natyrës së vetë nuk janë të matshme.

Gjatë përcaktimit të statuseve të përmbushjes për çdonjërin nga aktivitetet ekziston burim, i cili shërben si dëshmi dhe mbështetje se kodifikimi i të njëjtit është bërë në pajtim me udhëzimet e parapara metodologjike.

## Bibliografia:

---

Qeveria e Republikës së Maqedonisë. “Plani 3-6-9.” Sekretariati për çështje evropiane, 4 korrik, 2017. <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan%203-6-9%20MK.pdf>.

Grupi i ekspertëve. “Vlerësim dhe rekomandime I grupit të ekspertëve për çështje sistemore nga sundimi i të drejtës 2017.” Komisioni Evropian, 2017. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf).

———. “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Rekomandime të grupit të ekspertëve për çështje sistemore të sundimit të të drejtës të ndërlidhura me përcjelljen e komunikimeve të publikuara në pranverë të vitit 2015.” Komisioni Evropian, 2015. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf).

Komisioni Evropian. “Raport për ish Republikën Jugosllavët e Maqedonisë 2015.” Komisioni Evropian, 2015. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf).

———. “Raport për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2016.” Komisioni Evropian, 2016. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf).

Zaev, Zoran. “Deklaratë e E.T. Zoran Zaev, Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në sesioni e 72-të në seancën plenare të Asamblesë së përgjithshme të kombeve të bashkuara.” Organizata e kombeve të bashkuara, 2017. [https://gadebate.un.org/sites/default/files/gastatements/72/mk\\_en.pdf](https://gadebate.un.org/sites/default/files/gastatements/72/mk_en.pdf).

Komisioni për çështje evropiane. “Deklaratë për përsheptimin e proceseve reformuese dhe Integruese për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian dhe në NATO.” Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, 14-ët korrik, 2017. [https://www.sobranie.mk/2016-2020-srm-ns\\_article-komisijata-za-evropski-prashanja-go-razgleda-planot-3-6-9.nsp.x](https://www.sobranie.mk/2016-2020-srm-ns_article-komisijata-za-evropski-prashanja-go-razgleda-planot-3-6-9.nsp.x).

Sekretariati për çështje evropiane. “pasqyrë e Akteve Nacionale Juridike të cilat janë lëndë e harmonizimit me legjislativin e UE 2016,” 17 mars, 2016.

———. “Nacionale Juridike të cilat janë lëndë e Harmonizimit me Legjislativin e UE 2017-2020,” 17 mars, 2016.



**GARA E 3, 6 DHE 9 ME PENGESA**  
Vëzhgim i zbatimit të tre muajve  
të parë të Planit 3-6-9

*Nëntor 2017*